



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

FTESË PËR NEGOCIATË
PËR
AGJENCITË E SPECIALIZUARA PËR SHËRBIM ARTGRAFIK.

Në mbështetje, vendimit nr.1195, datë 05.08.2008, të Këshillit të Ministrave “Për blerjen, zhvillimin prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” dhe vendimit nr. 230 datë.27.12.2022 “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve do të realizojë “Shërbim artgrafik”.

A- OBJEKTI

“Shërbim artgrafik” për realizimin dhe prodhimin të materialeve informative artistike, zgjedhore dhe materialeve promocionale për proceset zgjedhore gjatë gjithë vitit kalendarik.

Periudha e realizimit: Realizimi i shërbimeve do të jetë 5 ditë nga kërkesat që do të vijnë KQZ sipas tematikës së kërkuar përgjatë 9 muajve.

Fondi limit i përcaktuar: Fondi limit i procedurës është në vlerën **1,200,000 (një milion e dyqind) lekë pa Tvsh.**

Kohëzgjatja e kontratës: 9 (nëntë muaj)

Publikimi i ftesës për negociatë: 20 mars 2023

Afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit është data 27 mars 2023 ora 16:00.

Ofertat duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jotransparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës **27 mars 2023, ora 16.00.**

Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Autoritetit tonë kontraktor:

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr.4

Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip

Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt "Shërbim artgrafik", kriteret do të jenë si më poshtë.

B- TERMAT E REFERENCËS

Qëllimi i këtij shërbimi është: Përgatitja e materialeve informative, materialeve zgjedhore dhe promociionale të procesesit zgjedhor. Shërbim artgrafik që përfshijnë dizenjimin, realizimin dhe prodhimin artistik të materialeve informative dhe promociionale të KQZ, për të garantuar infografe me të dhëna statistikore për publikun e gjerë, imazhe/postera për individ dhe subjekte të ndryshem politike si dhe dizenjimi i materialeve të ndryshme si broshura, badge, tabela para dhe pas fushatave zgjedhore.

Përshkrimi:

Shërbim artgrafik, për realizimin dhe prodhimin të materialeve informative artistike dhe materialve promociional për proceset zgjedhore gjatë gjithë vitit kalendarik.

Shërbim artgrafik që përfshijnë dizenjimin, realizimin dhe prodhimin artistik të materialeve informative dhe promociionale të KQZ, për të garantuar infografe me të dhëna statistikore për publikun e gjerë, imazhe/postera për individ dhe subjekte të ndryshem politike si dhe dizenjimi i materialeve të ndryshme si broshura, badge, tabela para dhe pas fushatave zgjedhore.

C- SHËRBIMET QË KËRKOHEN TË REALIZOHEN:

1. Imazhe ku jepen orientime të ndryshme për ndjekësit në lidhje me kanalet e informimit.
2. Infografe me të dhëna dhe stastistika të cilat paraqiten me anë të figurave dhe grafikëve të cilat tregojnë të dhëna historike të zgjedhjeve, të dhëna statistikore dhe që përbejnë interes për publikun e gjerë.
3. Imazhe që bëjnë thirrje për pjesëmarrje sa më të gjerë të grupeve të ndryshme të shoqërisë në zgjedhje siç janë rinia dhe votuesit për herë të parë.
4. Imazhe me thënie nga personazhet e institucionit (komisionerë/përfaqësues).

5. Postera/imazhe që bëjnë thirrje për individët dhe subjektet e ndryshme politike për shpallje, procese, aplikime, afate.
6. Infografe periodike me të dhënat e rezultateve gjatë proceseve zgjedhore dhe shpalljeve të rezultateve.
7. Dizajni i materialeve për shtyp, broshura, brandim etj.
8. Dizajni i materialeve të dedikuara për vitin zgjedhor si veshje, badge, tabela identifikuese/sinjalizuese, materiale zgjedhore, dokumenta zgjedhore.

Ç- INFORMACION DHE KËRKESA SPECIFIKE NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Kriteret e pranimit/kualifikimit

1- Kriteret e përgjithshme ligjore:

- A. Ekstrakti i shoqërisë, që është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.
- B. Nuk është në proces falimentimi (status aktiv).
- C. Vërtetim që nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së.
- D. Deklaratë që nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- E. Deklaratë që ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- F. Deklaratë që kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

2- Kriteret e përgjithshme profesionale:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një portofol të punëve të kryera gjatë 3 viteve të fundit të ngjashme me objektin e ftesës për ofertë.
2. Ofeta ekonomike: Operatorët do të duhet të paraqesin ofertën ekonomike të detajuar sipas zërave të shërbimit të paraqitur më sipër në vlerën pa tvsh dhe me tvsh.
3. Operatorët ekonomik do të paraqesin një projekt ide/ zgjidhje teknike/ propozim për realizmin e shërbimeve që kërkohen.

D- KRITERET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i ofertës ekonomike më të favorshme sipas pikëzimit të mëposhtëm:

- **Kriteret e përgjithshme ligjore: 10 pikë**
- **Kriteret e përgjithshme profesionale: 20 pikë**
- **Oferta financiare 40 pikë**
- **Zgjedhja teknike/propozimin për realizimin e shërbimit (project ideja) 30 pikë**

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Protokollit, përpara orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Kjo ftesë për negociata do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: www.kqz.gov.al